



Datë: 30.12.2025
Numër Protokolli: 8149/2025

A.nr.1610/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1610/2025, të datës 20.08.2025, të parashtruar nga ankuesi Xh.I, kundër organit të punësimit: Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1610/2025, e datës 20.08.2025, e parashtruar nga ankuesi, Xh.I.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli Nr.35741/25, i datës 24.07.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, lidhur me shpalljen e kandidatës të suksesshme, në procedurën e pranimi më numër reference RN00017867.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, Xh.I (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 20.08.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017867, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Sektorit të Financave edhe Kontabilitetit*”, të shpallur nga Komuna e Vushtrrisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vushtrrisë, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 5550/2025, të parashtruar nga ankuesi më datë 20.08.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për verifikim paraprak me numër protokolli 2963/25 të datës 30.06.2025; Njoftim për test elektronik Nr.31604/25, të datës 08.07.2025; Njoftimin me Nr.33376/25 të datës 15.07.2025; Njoftimin

Nr.34990/25, të datës 22.07.2025; Njoftimin për intervistë të datës 24.07.2025; Njoftimin për rezultatin përfundimtar Nr.35741/25 të datës 24.07.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimin e ankesës; Plotësimin e ankesës nga ankuesi të datës 21.08.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.08.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 01.09.2025, së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Konkursin me Nr.ref. RN00017867, të datës 19.05.2025; Hapjen e konkursit Nr.19228/25 të datës 05.05.2025; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 08.07.2025; Rezultatet e testit me shkrim; Vendimin Nr.31346/25 të datës 07.07.2025; Akt emërimit Nr.27135/2025 të datës 18.06.2025; Akt emërimit Nr.27214 të datës 18.06.2025; Akt emërimit Nr.27129/25 të datës 18.06.2025; Akt emërimit Nr.10201/25 të datës 07.03.2025; Akt emërimit Nr.6425/25 të datës 10.02.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 12.06.2025 i kandidatës L.H së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 17.06.2025 i kandidatit Xh.I së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimi me Nr.6534/2025 i Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e papabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Vushtrrisë, më datë 19.05.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00017867, për pozitën e punës *“Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit*, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, një (1) vend i lirë pune, me mandat katër (4) vjeçar, i hapur për aplikim nga data 20.05.2025 deri më datën 18.06.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesi i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, dhe se i njëjti i është nënshtruar vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim është vlerësuar më 54.4 pikë, ndërsa në intervistën më gojë më 22.8 pikë, gjithsej 77.2 pikë, mirëpo sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të vlerësimit ankuesi është renditur si kandidati i dytë me më shumë pikë të arritura, rrjedhimisht, si kandidate me më së shumti pikë rrjedhë të jetë L.H me gjithsej 90.2 pikë (64.8 pikë në testin me shkrim dhe 25.4 pikë në intervistën më gojë), ashtu që, edhe e njëjta është shpallura edhe kandidate fituese sipas Njoftimit me numër protokolli Nr.35741/25, të datës 24.07.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017867. Shton se nuk janë respektuar rregullat gjatë procesit të testit me shkrim, me theks të veçantë mos mbajtja e telefonave në tavolinë gjatë mbajtjes së testit me shkrim, po ashtu sipas ankuesit gjatë këtij procesi të rekrutimit Komisioni i Pranimit ka favorizuar kandidaten fituese. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, duke e obliguar Komunën e Vushtrrisë që ta anuloj procesin e rekrutimit në tërësi.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00017867, respektivisht për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit të Financave dhe Kontabilitetit* dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i**

kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet, **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj së kriteret e përgjithshme për pozitën përkatëse të punës kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 9: 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj. 2. Përgjithësisht, për pozita specifike të zyrtarëve/publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministritë përgjegjëse për administratë publike.

-Nenit 44 :1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësi përgjegjëse, në SIMBNj-së, në uebfaqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë.

-Nenit 45: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese në administratën shtetërore bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil ekzistues të kategorisë së njëjtë apo më të lartë; 2.2. një (1) nëpunës/ës civil nga njësi përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës civil me njohuri në fushën e pozitës së lirë. 3. Komisioni i pranimi zgjidhet ad hoc për çdo pozitë nga lista e kandidateve/ë

Po ashtu, Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me konkret:

- Nenin 7: Verifikimi paraprak 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit. 3. NjMBNj publikon në SIMBNj dhe uebfaqen e institucionit listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato specifike. 4. NjMBNj njofton kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për

rekrutim, duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e pa përmbushura jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve.

-Nenin 8: Vlerësimi profesional Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimi me mbështetjen e NjMBNj.

-Neni 9: Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimi e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNJ, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.

-Nenin 10: Vlerësimi nëpërmjet intervistës 1. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën, e cila realizohet në mënyrë verbale e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë. 3. Komisioni i Pranimi njofton kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim lidhur me ditën, kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës. 4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 5. Intervista zhvillohet nga Komisioni i Pranimi i cili përgatit apo përzgjedh nga bankat e pyetjeve grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. Këto pyetje duhet të përgatiten/përzgjedhin në ditën e zhvillimit të intervistës, përveç pyetjes për prezantim nga paragrafi 7 i këtij neni që përzgjidhet dhe u dërgohet kandidatëve së bashku me njoftimin për orarin e intervistës. 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimi mund të parashtrajnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 7. Intervista për kandidatët për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese bazohet në kompetencë dhe përmban pesë (5) pyetje të cilat vlerësohen me më së shumti tre (3) pikë, si dhe një (1) pyetje për prezantim e cila vlerësohet me më së shumti 5 pikë. 8. Secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimi bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje. 9. Në intervistë kandidati mund të marrë më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV). 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante.

11. Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të gjithë anëtarëve.

-Nenin 11: Shpallja e rezultatit përfundimtar 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i përmbajtjes së testit me shkrim të aplikuar në këtë procedurë rekrutimi, ka vërtetuar së pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët, testi ka përmbajt 25 pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja, pra testi me shkrim ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, ankuesi në pyetjet me përgjigje të shumëfishta ka dhënë 20 përgjigje të sakta duke grumbulluar gjithsej 40 pikë (çdo përgjigje e saktë është vlerësuar me nga dy pikë) ndërsa, në ese është vlerësuar më 14.4 pikë, nga 20 pikët maksimale, ndërsa, kandidatja L.H ka arrit 48 pikë në pyetjet për disa opsione, kurse, në ese është vlerësuar më 16.8 pikë. Andaj, mbi këto rrethana Kolegji nuk verën të meta në vlerësimin e drejtë të ankuesit lidhur me esenë, kështu që edhe pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk gjen mbështetje. Ndërsa, lidhur me pretendimet tjera në ankesë, ankuesi më asnjë prove nuk ka arrit të argumentoj këto pretendime.

Po ashtu, Kolegji nga administrimi i provave të çështjes ka gjetur së nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit së organi përkatës i punësimit në këtë procedurë të rekrutimit ka bërë shkelje ligjore, sepse dyshohet në ndikimin e anëtareve të komisionit të pranimit për përzgjedhje të kandidatit fituese, ngase, nga analizimi i dosjes së aplikimit të kandidatës fituese L.H (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë) ka gjetur se e njëjta posedon Diplomën me Nr.191/11, të datës 30.12.2011, të lëshuar nga Kolegji Dardania, më të cilin vërtetohet se më datë 29.11.2011 ka mbaruar studimet themelore në Programin Banka Financa dhe Kontabilitet duke marrë titullin Bachelor i Arteve në Banka, Financa dhe Kontabilitet; ndërsa për sa i përket përvojës së punës pas diplomimit kandidatja ka bashkangjitur Akt emërimit Nr.32/13 të datës 16.01.2013 me të cilin vërtetohet se ka qenë e emëruar në pozitën e punës Zyrtare për taksa komunale në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa; Akt emërimit me numër Nr.455/16, të datës 16.05.2016 me të cilin vërtetohet se ka qenë e emëruar në pozitën e punës Zyrtare për kontabilitet në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa; Akt emërimit Nr.37444/24, të datës 01.08.2024, me të cilin vërtetohet se ka qenë e emëruar në pozitën e punës Zyrtare e lartë për financa në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa; Vendimin Nr.1717/24, të datës 19.11.2024 të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë me të cilin vërtetohet se kandidatja është caktuar me detyrat dhe përgjegjësitë për aprovim të zotim obligimeve dhe kërkesë me blerje në SIMFK; Vendimin Nr.314/2025 të datës 14.03.2025, të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë me të cilin vërtetohet se kandidatja është caktuar me detyrat dhe përgjegjësitë për aprovime të zotim obligimeve dhe kërkesë me blerje në SIMFK; Vendimin Nr.1298/2025 të datës 09.11.2021, të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë me të cilin vërtetohet se kandidatja është caktuar me detyrat dhe përgjegjësitë për aprovim të zotimeve dhe pranimit të mallit për organizatë buxhetore. Andaj, nisur kjo gjendje e fakteve rezulton se kandidatja e shpallur fituese L.H ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkurs, e duke qenë se e njëjta në fazën e vlerësimit ka arritur numrin më të madh të pikëve të vlerësimit, atëherë, konsiderohet edhe si kandidate e suksesshëm për këtë procedurë të pranimit, kështu që, mbi këtë bazë, njësia përgjegjëse në këtë rast Njësia e Personelit në Komunën e Vushtrrisë ka vepruar pajtim me nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke e shpallur të njëjtën si kandidate fituese.

Bazuar në konstatimet si me lartë, dhe duke qenë se nuk janë evidentuar shkeljeje ligjore në procedurën e kontestuar, atëherë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura me numër reference RN00017867, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1610/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Xh.I;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.